



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/03-5259/21
Kaçanik, 23.02.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II-të (Dytë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23 Shkurt 2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të 6 anëtarë: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Hafize Sallahi, Rabije Sallahi. Në mbledhje mungoj me arsye, Selim Reka

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës – Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani dhe Ukshin Qallaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë në mbledhje janë 6, ndërkaq me arsye mungon Selim Reka -për shkak të infektimit me korona-virus. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II-të (Dytë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 23 Shkurt, me këtë

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2020;
3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2020;
4. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2020;
5. Propozim Vendimi për lirim nga qiraja komunale, për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021; dhe
6. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën: Janar- Dhjetor 2020.

Kryesuesi i Kuvendit, Pikët 5 dhe 6 nuk janë sipas Ftesës për mbledhje, materiali për këtë pikë është shpërndarë tani, a jeni të pajtimit që të hyjnë në rend pune këto dy pikë ?

z. Nexhat Loku, Në emër të GP të PDK, pasi që materiali nuk është i gjerë, unë jam që t'i diskutojmë edhe këto dy pikë dhe t'i procedojmë për KK.

z. Ekrem Kyçyku, Unë jam kundër për faktin se edhe materiali për pikët 2 dhe 3 na ka ardhur me vonesë, ndërkaq dihet afati së kur duhet të kemi materialin e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, Sa i përket dërgimit të materialit, të premtën ka pasur problem me energji elektrike, kështu që nuk kanë mundur të dërgohet materiali për të gjitha. Për KPF ndoshta është pak me vonesë materiali, mirëpo për KK, është me kohë. Unë për kundër se kemi pasur pak material, kam insistuar me u thirrur mbledhja, për shkak edhe të mëditjeve të anëtarëve të KK. Nëse jeni të pajtimit të gjithë, atëherë procedojmë edhe pikët 5 dhe 6.

z. Ekrem Kyçyku, Materiali për pikët 2 dhe 3 as për KK nuk na ka ardhur me kohë, sepse është dashur 7 ditë me herët me i pasur materialin e mbledhjes.

z. Nexhat Loku, Kërkoj nga kryesuesi që të shtroj me këto dy pikë rendin e punës. Nëse kalojnë, procedojmë me shqyrtimin e këtyre dy pikëve, nëse jo, atëherë i heqim nga rendi i punës.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë rendin e propozuar të punës me shtimin e pikëve 5 dhe 6 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së I-r (Parë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 25.01.2021 /Lënda: 01Nr. 060/01-1990/21.

2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, edhe pse pak me vonesë, besoj se keni pasur kohë me lexuar. Për këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Materialin e kemi marrë me vonesë për këtë pikë, sa e pash unë, pjesa e raportit të DSHMS në krahasim me vitin e kaluar është shumë i mangët. Në vitin e kaluar raporti ka përfshirë të dhënat lidhur me analizat e ujit; sa analiza të ujit janë bërë, sa mostra janë marrë, gjërat që janë shqiptuar nga inspektorati i shëndetësisë, ndërkaq tani në këtë raport nuk ka të dhëna. Unë nuk do të diskutoj tani më, më gjerësisht do të diskutoj në KK, për shkak së nuk kam arritur me lexuar krejt materialin.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që ky raport t'i shkoj KK në procedurë? Rezultati i votimit është njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, u

Njoftua

Me Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2020; dhe i njëjti i kalohet KK në procedurë për diskutim.

3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, para se më hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi;

z. Bahri Selimi-drejtor i DEFZH, Viti 2020 të gjithë e dimë së ishte vit pandemie, ndërkaq ne e dimë së të gjitha çështjet lidhen me financa. Në jemi munduar në bashkëpunim me KK me marrë vendime të ndryshme, si për ridestinim të mjeteve, pastaj ndarjen e fondit në shumë, 100 mijë euro të cilin e patëm krijuar në bashkëpunim me juve për çështjen e Covid-19. Bile bile ka pasur nevojë edhe për më tepër mjete buxhetore për këtë qëllim. Unë e kam pasur plan këtë raport me sjellë për shqyrtim në muajin mars, për shkak së i njëjti është dërguar në MEF- Thesar, dhe i njëjti është standard ashtu siç është dërguar në ministri, ndërkaq deri me 24 të këtij muaji bëhen rishikimet dhe i dërgojmë edhe një herë pasqyrat financiare, por aty nuk mund të lëvizin shumë të dhenar, për 0.01%. Meqë nuk kishte shumë pikë për KPF dhe KK, atëherë unë e procedova për KPF dhe për KK raportin ashtu siç është dërguar në ministri. Për seancë, nëse ka ndonjë kërkesë për dizajnim, mundem me ndërhyrë. Në përgjithësi ekzekutimi i mjeteve buxhetore është në nivel, me përjashtim të HVK kanë ngelur pa shpenzuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Në f. 25 dhe 26, detyrimet kontingjente të cilat janë në procedurë gjyqësore, po shihet së janë bukur shumë detyrime të tilla. A dihen lëndët përafërsisht së për çka bëhet fjalë, natyra e padisë së për çfarë qëllimi është fjala, si fjala vjen , për vërtetim pronësie, etj.?

z. Bahri Selimi, Këto janë çdo kontest gjyqësor që janë në procedurë. Ne e kemi për detyrë me i paraqitur, auditorët na thonë me i paraqitur, sepse nëse ndodhë me humbur kontestin, mjetet duhet me u paraparë paraprakisht. Nuk është së janë paguar, ato që janë me vlera, e dimë sesa ka me ndodhur shuma e kontestit të disa, si të, pagat jubilarë, të cilat mjete pritet të na i marrin. Kemi edhe padi nga qytetarë të ndryshëm e që nuk dihen vlerat.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky raport t'i shkoj KK në procedurë për diskutim ? Për ishin të gjithë, kështu që konstatohet së KPF u,

Njoftua

Me Raportin Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2020, dhe i njëjti i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë për diskutim.

4. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, në këtë raport është përfshirë në pika të shkurtër aktiviteti i KPF. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që ky raport t'i adresohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim? **KPF u pajtua njëzëri që raportin e punës së saj për vitin 2020, me ia adresuar Kuvendi të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim.**

5. Propozim Vendimi për lirim nga qiraja komunale, për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materiali është i shkurtër, qëllimi dihet pse lirohen bizneset nga qiraja, për shkak të pandemisë. Është një propozim i mirë, besoj se ia vlen me i liruar bizneset nga qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale. A jeni që ky Propozim Vendim t'i shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. KPF njëzëri u pajtua që të lirohen nga qiraja shfrytëzuesit e pronës komunale. Në bazë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për lirim nga qiraja komunale, për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021, të përcaktuar në nenin 16 të Rregullores për Taksat Komunale, dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën: Janar- Dhjetor 2020.

Kryesuesi i Kuvendit, Materiali ka ardhur me kohë, por është përvjedhur një gabim këtu dhe lënda nuk është proceduar. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo informatë t'i kalohet Kuvendit të Komunës. Me proceduar për KK këtë Informatë u pajtuan njëzëri të gjithë, kështu që konstatohet së KPF u,

Njoftua

Me aktivitetin e Zyrës së menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën: Janar- Dhjetor 2020.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora: 11:20. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët sa ishin në mbledhje. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 26 Shkurt 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

